

RISHPALLJE E THIRRJES PËR SHPREHJE INTERESI PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË SHOQËRISË CIVILE QË DO TË KRYEJNË VERIFIKIMIN PARAPRAK TË KANDIDATURAVE PËR ANËTARIN QË PËRFAQËSON SHOQËRINË CIVILE, NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Bazuar në ligjin nr. 115/2016 datë 3.11.2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka publikuar shpalljen e vendeve vakante dhe thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga anëtarët e organizatave të shoqërisë civile. Në zbatim të detyrimeve sipas pikës 10 të nenit 56, Avokati i Popullit rishpall thirrjen për shprehje interesi për anëtar të komisionit të shoqërisë civile, që do të kryejnë verifikimin paraprak të kandidaturave për anëtarin që përfaqëson shoqërinë civile, në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Shprehja e interesit, duhet të paraqitet nga organizatat e shoqërisë civile brenda një afati 5 ditor nga dita e publikimit të kësaj thirrjeje, dhe duhet të përmbajë dokumentacionin origjinal, ose të noterizuar, që vërteton plotësimin e kriterëve ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 54, të Ligjit nr.115/2016 datë 3.11.2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ku përcaktohet se: “Kuvendi zgjedh 1 anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga anëtarët e organizatave të shoqërisë civile, të regjistruara sipas legjislacionit përkatës, të cilët punojnë në fushën e sistemit të drejtësisë ose të të drejtave të njeriut dhe që kanë zbatuar projekte në këtë fushë të paktën 5 vitet e fundit”.

Shprehja e interesit dhe dokumentacioni përkatës që vërteton plotësimin e kërkesave të mësipërme ligjore, duhet të dorëzohen brenda datës **07.08.2023** në një nga format e mëposhtme:

- fizikisht ose në rrugë postare pranë institucionit të Avokatit të Popullit në adresën: Bulevardi “Zhan D’Ark”, nr. 2, Tiranë, ora: 08:30-16:30. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda afatit të përcaktuar për dorëzimin e dokumenteve, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar;

- nëpërmjet postës elektronike në adresën info@avokatipopullit.gov.al;

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke vlerësuar bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile një bashkëpunëtor kyç në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, nxitjen e standardeve më të larta të të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës në vend, nxit pjesëmarrjen e sa më shumë organizatave të shoqërisë civile në këtë proces tepër të rëndësishëm për sistemin e drejtësisë.